



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2020:069937
Datë: 07.03.2024
Numri i dokumentit: 05423091

E.nr.1601/22

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, gjyqtari Faton Ajvazi me sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit M.Y. nga Ferizaj, të cilin e përfaqëson av Leutrim Ademi nga Mitrovica, kundër debitorit Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, për pagesën e borxhit dhe shpenzimeve të procedurës, më datë 07.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDON procedura përmbarimore në lëndën **E.nr.1601/22**, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorit.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.1601/22, të datës 19.12.2022, e ka caktuar përmbarimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorit, kundër debitorit Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, për pagesën e borxhit dhe shpenzimeve të procedurës, në bazë të aktgjykimit C.nr.984/20, të datës 10.11.2022.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përmbarimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimet e datës 13.02.2023 dhe 07.03.2024, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës, që nga llogaria e debitorit, t'i transferoj shumat e mjeteve prej 1,065.35 euro dhe 183.46 euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorit

Meqenëse kreditori e ka realizuar kërkesën e tij, Gjykata konstatoj se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së, dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përmbarimore në këtë çështje juridike përmbarimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
E.nr.1601/22, më datë 07.03.2024

GJYQTARI
Faton Ajvazi